



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

URDHËR

Nr. 98, datë 29/10 2024

PËR

**“MARRJEN E MASAVE PËR ORGANIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E
KONKURSEVE TË PRANIMIT REFERUAR URDHËRIT TË PËRBASHKËT
NR. 161, DATË 25.10.2024, PËR VITIN AKADEMIK 2024 – 2025
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Organizimi i konkurseve në mbështetje të Urdhrit të Përbashkët nr.161, datë 25.10.2024 për disa ndryshime në urdhrin e përbashkët nr. 112, datë 05.07.2024, “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024 – 2025”, në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve, të cilat kanë kuota të lira, zhvillohet si më poshtë vijon:

1. Regjistrimi i konkurrentëve për në konkurset e pranimit për të gjitha programet e studimit bëhet pranë sekretarive mësimore në **datat 30 tetor - 5 nëntor 2024, nga ora 08:00 deri në orën 16:00.**

Dokumentacioni për t’u regjistruar në konkurset e pranimit është:

- Mandati i pagesës së tarifës së konkurimit;
 - Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës.
2. Konkurset e pranimit nga fakultetet e UART do të zhvillohen **në datat 5 – 6 nëntor 2024.**
 3. Në datën **6 nëntor 2024** shpallen **konkurrentët fitues.**
 4. Në datën **7 nëntor 2024**, kryhet regjistrimi i **kandidatëve fitues** pranë sekretarive mësimore me dokumentacionin:



- Diplomë e shkollës së mesme dhe lista e notave e printuar nga e-Albania (*me vulë elektronike*), ose Diploma dhe lista e notave e shkollës së mesme (*të noterizuar nëse nuk janë me vulë elektronike*).
 - Mandati i pagesës së tarifës të konkurrimit;
 - Fotokopje të kartës së identitetit ose të pasaportës.
 - Dy fotografi.
5. Sekretaritetë mësimore kryejnë regjistrimin e studentëve brenda datës **8 Nëntor 2024**.
6. Sektori i Shërbimeve si dhe fakultetet në UART të marrin masat e nevojshme për përgatitjen e ambienteve në të cilat do të zhvillohen konkurset e pranimit për të gjitha programet e studimit.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri çdo strukturë në ndihmë të këtij procesi në UART.
8. Ky Urdhër të shpallet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Arteve

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë

